



Pranimi / Dorezuar / Prijeto / Protato / Received / Dorety	07-12-2022	2	viti / god / year
Organ / Mjesa / Organ / Jednica / Org. Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPINSACK	7748/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 957/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolejti për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani -Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koci, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.957/2022, të datës 27.10.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rruga

kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “ vërejte me shkrim ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr. 957/2022, të datës 27.10.2022, të parashtruar nga ankuesja.
- II. SHFUQIZOHET, vërejtja e datës 18.10.2022, me numër protokoli 02/116/11-23463, e shqiptuar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Punë të Përgjithshëm Administrative, në Komunën e Gjakovës.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës e punësuar në Komunën e Gjakovës me datë 27.10.2022, me numër protokoli 6497/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër “vërejtjes” së datës 18.10.2022, me pretendimet ankimore lidhur me vërjetjen e dhënë nga Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshëm Administrative, në Komunën e Gjakovës, ku ankuesja pretendon se Drejtori nuk ka arrit të konstatoj sakt gjendjen faktike dhe të peshoj drejtë

gjenjen juridike se cilën shkelje e kam bërë. me datë 18.10.2022, me numër protokolli02/116/11-23463, i ka shqiptuar vërtetje me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 31.10.2022, me numër protokolli 6571/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa me datë 17.11.2022 me numër protokolli 7189/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 957/2022 e datës 27.10.2022, me numër protokolli 6497/2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetje e datës 18.10.2022. me numër protokolli 02-116/11-23463; Statistika e Regjistrimit të Lindjes së Sistemit të Gjendjes Civile; e- maili i datës 06.01.2022; e- maili i datës 06.06.2022; e- maili i datës 26.06.2022; e- maili i datës 27.06.2022; e- maili i datës 29.06.2022; e- maili i datës 07.01.2022; e- maili i datës 15.07.2022; e- maili i datës 17.08.2022; e- maili i datës 18.08.2022; e- maili i datës 30.08.2022; e- maili i datës 19.09.2022; Vendimi A. Nr. 108/2022, i datës 28.03.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 28.04.2022, me numër protokolli 01-070/01-10770, i Komisionit Disiplinor; Akt Emërimi i datës 13.12.2021; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Ankesë e datës 01.02.2022; Ankesë e datës 25.03.2022, drejtuar Drejtorisë së Administratës; Ankesë e datës 28.03.2022, drejtuar Drejtorisë së Administratës; Ankesë e datës 11.10.2022, Kryetarit të Komunës së Gjakovës; Përgjigje në ankesë e datës 17.11.2022, me numër protokolli 7189/2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar ,sepse:*

Kolegji, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankueses lidhur me vërtjetjen se në datën e caktuar ka pasur shumë njerzë duke pritur në sektorin e gjendjes civile dhe bazuar në shkresat e lëndës për të cilën mbikëqyrësi ka shqiptuar vërtetje, konstaton se në datë 18.10.2022 në sektorin e gjendjes civile janë dhënë 229 shërbime, janë regjistruar 10 lindje, 3 vdekje dhe dy martesë të gjitha këto shërbime janë të argumentuara, prandaj nuk qëndron pretendimi i mbikëqyrëses se ankuesja në cilësinë e Shefes se Gjendjes Civile nuk e ka kryer punën konform dipozitave ligjore në fuqi.

Kolegji ka shqyrtuar me kujdes edhe vërejtjen e shqiptuar nga mbikëqyrësi i cili me asnjë fakt nuk arrin të argumentoj se ankuesja ka sjellje jo etike, tendencioze, sjellje jo korrekte ndaj stafit politikë,....Prandaj Vërejtja është në kundërshtim me nenin neni 48, paragrafi 1 dhe, nën paragrafi 1. 2, të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi:

Kolegji ka trajtuar edhe ankesat e qytetarëve ndaj ankueses të cilat ankesa në asnjë rrethanë a po fakt nuk argumentojn me asnjë të dhënë se ankuesja nuk ka kryer punën e saj sipas dispozitave ligjore, për më tepër ato deklarata shumica janë të fillim vitit 2022. Kolegji ka



pasur parasysh kur ka aprovuar ankesën e ankuese se e njëjta nuk ka në fuqi asnjë masë disiplinore.

Në bazë të shkresave të lëndës Kolegji nuk ka arritur të konstatoj me asnjë dëshmi se ankuesja ka vepruar në kundërshtim me nenin 25, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji Nr. 06/1 - 114 për zyrtarët Publikë, ku thuhet shprehimisht se; 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës, prandaj Kolegji ka marrë përë bazë të gjitha kto rrethana kur ka vendsor të bëjë aprovimin e ankesës

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A. NR. 957/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankueses

Kryetarit të Komunës së Gjakovës;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës;

Arkivit të KPMSHCK-së,

